



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



interesave Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 83-të të mbajtur më 27.02.2023 ka miratuar si në vijim.

VENDIM

Denoncimi I regjistruar sipas numrit 12-7061/1 të datës 17.12.2021, kundër personit -----, drejtues në, "-----" – -----, HIDHET POSHTË.

KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë për arsye se personi kundër të cilit i referohen pretendimet nuk është person zyrtarë në pajtim me nenin 8 paragrafi 2 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

Lënda me numër 12-7061 të vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

ARSYETIM

Nga një parashtrues i njohur, -----, më datë 17.12.2021 është dorëzuar denoncim për personin ----- dhe është formuar lënda me numër 12-7061/1 të datës 17.12.2021.

Në denoncim parashtruesi thekson se si person zyrtar është ortak me 33,18% në "-----" – ----- nga. -----, Komuna-----, ndërsa drejtues i personit fizik është -----, kundër të cilit është paraqitur denoncimi.

Në denoncim thuhet se drejtuesi i personit juridik të përmendur në mënyrë të pavarur ka marrë vendime lidhur me veprimtarinë e subjektit dhe ka kërcënuar personat që nuk pajtohen me veprimet e tij. Ai është denoncuar disa herë në Ministrinë e Punëve të Brendshme në -----, por situata me sjelljen e tij nuk ka ndryshuar.

Për kërkesat e bashkëpunëtorëve të "-----" – -----, përveç që i kanë shkruar drejtuesit të tyre -----, ata kanë dërguar edhe kërkesë me shkrim në Prokurorinë

Themelore Publike ----- për të cilën është ngritur lëndë dhe sipas të njëjtës, tashmë janë ndërmarrë veprimet përkatëse nga Prokuroria Themelore Publike -----.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja ka konstatuar se në rastin i raportuari nuk është person zyrtar në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, pas së cilës ka konstatuar se nuk ka elemente për veprim kompetent ndërsa parashtruesi drejtohet që të fillojë procedurën gjyqësore në organin kompetent të gjykatës.

Në bazë të sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Dorëzuar:

- parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: MR. K.Z

KOMISIONI SHTETËRORE
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Nënkryetar
Katica Nikolovska